

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**KOMISIONERI
PËR TË DREJTËN INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE**

Raporti Vjetor 2019



"The perfect ending to a wonderful @icdppc2019, during which regulators from all over the world have agreed to a new policy strategy and convergence and accountability have been at the centre of the discussions. Thank you @idpAlbania @ICDPPCec, thank you #Albania."



"Another pleasant Albanian surprise – not your traditional perfunctory greeting. Thank you Edi Rama. #ICDPPC2019"

"The house of an Albanian belongs to God and guests. And God doesn't always show up, so guests are gods"

"Notable that @icdppc2019 is being held in Albania, a country that within recent memory was one of the most isolated in the world. Now, the Albanian Commissioner opens a global event to discuss #privacy, AI, human rights, and more"



"Closing of International Conference of Data Protection and Privacy Commissioners...many insights on priorities of regulatory convergence and accountability. Great hospitality and agenda by Albanian IDP and ICO #ICDPPC2019."

"A fantastic week in Tirana, Albania at #icdppc2019. A packed agenda with some defining discussions on subjects such as accountability, convergence and connectivity, to name just a few. Great to see and meet friends and colleagues, old and new from all corners of the globe, truly demonstrating how important our role as privacy professionals in this digital age, and how what we do can make a real difference to people's lives. Many congratulations to the Commissioner and his team for a great conference, and already looking forward to Mexico next year"



"Great turnout for the opening of the 41st International Privacy Conference. Albanian Commissioner is welcoming delegates to Tirana. "Data protection has grown up; it's all around the world now". "Thank you #ICDPPC2019 host authority @IdpAlbania for a fantastic conference. Much has been achieved this week, including a new policy strategy which will move us towards greater regulatory cooperation and high data protection standards. See you in Mexico 2020"!



"Sad to leave Tirana. After checking out of the hotel the man at the front desk sent me on my way with a "Have a nice life"/ Urime dhe faleminderit @icdppc2019"



"It was a great pleasure to attend #ICDPPC2019. Tirana is a really interesting city and its people were all so nice. We have to come back; time was too short. Big Thank You to @IdpAlbania for hosting the event"



"Thank you @IdpAlbania for a wonderful international conference in Tirana, congratulations to the @ICDPPCec for the important resolutions adopted as well as the interesting agenda and debates in this @icdppc2019 hope to see you in #Mexico2020"



PËRMBAJTJA

MESAZHI I TITULLARIT	5
1. REFERENCAT LIGJORE KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT	6
2. E DREJTA E INFORMIMIT	7
2.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e programeve të transparencës së autoriteteve publike.....	7
2.1.1 Transparenca në administratën shtetërore dhe institucionet e pavarura	8
2.1.2 Transparenca në njësitë e vetëqeverisjes vendore	9
2.2 Trajtimi i ankesave	9
2.3 Hetime administrative	11
2.4 Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit (REKPDJ).....	11
2.5 Strategjitë Ndërsektoriale	12
3. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	13
3.1 Trajtimi i ankesave.....	13
3.2 Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”	13
3.3 Rekomandime dhe Urdhra	15
3.4 Sanksione administrative	15
3.5 Njoftimi.....	16
3.6 Transferimi ndërkombëtar	16
4. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE... 17	17
4.1 Hartimi i akteve ligjore	17
4.2 Dhënie mendimi për projektakte.....	17
4.3 Proceset gjyqësore	17
5. BASHKËPUNIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	19
5.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar, ndërinstitutional dhe me shoqërinë civile.	19
5.1.1 Marrëdhënia me EUROJUST	19
5.1.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar	19
5.1.3 Bashkëpunimi me shoqërinë civile	20
5.2 Trajnime.....	20
5.3 Aktivitete të tjera	21
6. MENAXHIMI BUXHETOR.....	22
6.1 Zhvillimi i Burimeve Njerëzore.....	22
6.2 Struktura Organizative	22
6.3 Të ardhurat dhe shpenzimet	22
6.4 Të ardhurat nga sanksionet	23
7. PROGRES RAPORTI I BE PËR SHQIPËRINË MBI ZYRËN E KOMISIONERIT	24

8. PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE	25
8.1 Procesi <i>screening</i>	25
8.2 Projekti i binjakëzimit.....	25
8.3 Raportime.....	26
9. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT 2019	27
10. NEVOJA PËR NDRYSHIME NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT	31
10.1 Përafrimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Direktivën e Policisë.....	31
10.2 Miratimi i projektligjit “Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” në kuadër të transpozimit të Direktivës së BE 2019/1024	31
10.3 Miratimi i projektligjit “Për thirrjet e pakërkuara”	31
11. VIZIONI I INSTITUCIONIT	32
ANEKS 1 - KONFERENCA E 41-të NDËRKOMBËTARE E KOMISIONERËVE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE DHE PRIVATËSISË (ICDPPC).....	33
ANEKS 2 - STRUKTURA DHE ORGANIGRAMA	39
ANEKS 3 - REKOMANDIMET E ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2019 PËR KONTROLLUESIT PUBLIK	41

MESAZHI I TITULLARIT

Misioni i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është garantimi i zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në përmbushje të tij, Zyra funksionon si mekanizëm për vendosjen e ekuilibrit mes këtyre dy të drejtave kushtetuese. Parimet dhe tiparet thelbësore të saj janë pavarësia, paanësia, besueshmëria dhe transparenca ndaj publikut.

Raporti i vitit 2019 është dokumenti gjithëpërfshirës i punës dhe veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vit i cili u karakterizua nga zhvillimi në Tiranë i aktivitetit më të rëndësishëm të mbrojtjes së të dhënave në nivel ndërkombëtar.

Viti 2019 shënjon edhe nisjen e një cikli të dytë për autoritetin, i cili vë përpara tij objektiva të reja. Nëse gjatë 5-vjeçarit të kaluar synimi kryesor qëndronte në konsolidimin e ligjit për të drejtën e informimit, sfida e autoritetit për këtë mandat është arritja e standardeve më të larta në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit nuk e ka shkëputur fokusin nga ajo që konsiderohet bërthama e veprimtarisë, shërbimi për qytetarët. U regjistruan 1087 ankesa dhe u ndërmorën 227 hetime administrative, mbi bazë ankese dhe kryesisht. Shifrat janë në rritje dhe kjo vjen si rrjedhojë e një pune sistematike në zbatim të kuadrit ligjor kombëtar, rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe detyrimeve ndërkombëtare. Njëkohësisht, vëmendje i është kushtuar dhe edukimit e ndërgjegjësimit të qytetarëve për ushtrimin në praktikë të të drejtave dhe lirive themelore që ata gëzojnë.

Ashtu sikurse titulli që i vendosëm Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë, në 21-24 tetor 2019 edhe objektivi ynë madhor gjatë këtij viti ka qenë pikërisht konvergjenca dhe bashkëpunimi.

Në një ekonomi të udhëhequr gjithnjë e më shumë nga të dhënat personale, ne shohim përfitimin e jashtëzakonshëm që sjell zhvillimi shkencor e teknologjik dhe ndërveprimi social. Tema më aktuale sot është garantimi i privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale, interesave dhe të drejtave të tjera të individit, në një ekuilibër të plotë me zhvillimin ekonomik. Forcimi i masave për sigurinë e të dhënave është detyrim themelor për të gjitha organizatat me qëllim rritjen e besimit të publikut.

Përfundimi i këtij viti kulminant, nuk mund të ishte i tillë pa angazhimin e çmueshëm të stafit të autoritetit, partneritetin e të gjithë aktorëve publik dhe privat, vendas e ndërkombëtar.

1. REFERENCAT LIGJORE KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT

Raporti i vitit 2019 bazohet në analizën e performancës institucionale të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me monitorimin dhe zbatimin e dy ligjeve kryesor:

- ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Të drejtat e parashikuara në ligjet e sipërcituara, janë pjesë e aktit më të lartë normativ të vendit tonë, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konkretisht në nenet 23 dhe 35 të saj. Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit mbështetet në zbatimin me korrektësi të legjislacionit shqiptar, të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018”, miratuar në Kuvend më datë 28.03.2019, si dhe detyrimeve që burojnë nga bashkëpunimi ndërkombëtar.

Kompetencat e Zyrës së Komisionerit për të dy fushat kryesore të veprimtarisë parashikohen në nenet 31 dhe 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Zyrës së Komisionerit i burojnë detyrime edhe nga ligje të tjera, si:

- ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”;
- ligji nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”;
- ligji nr. 113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet RSH dhe EUROJUST”.

2. E DREJTA E INFORMIMIT


Ushtrimi i të drejtës për informim në mënyrë proaktive nxit transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike, si një nga shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës. Zyra e Komisionerit, gjatë këtij viti, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka vijuar monitorimin e autoriteteve publike, të cilat kanë hartuar dhe/ose përditësuar programin e transparencës, forcimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit, përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve administrative, seancave dëgjimore dhe dhënien e rekomandimeve e vendimeve.

2.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e programeve të transparencës së autoriteteve publike


Publikimi i programit të transparencës dhe pasurimi i tij me informacion të përditësuar, mundëson rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike. Ky instrument garanton besueshmëri më të madhe të shoqërisë për përmbushjen e detyrave nga ana e autoriteteve publike, si dhe sjell eficensë në përdorimin e burimeve financiare. Ligji për të drejtën e informimit parashikon publikimin e programit të transparencës në format lehtësisht të kuptueshëm dhe të aksesueshëm, duke e vënë atë në dispozicion në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset publike. Në kushtet kur disa autoritete publike nuk kanë faqe zyrtare, rritet numri i kërkesave për informacion dhe për rrjedhojë edhe numri i ankesave pranë Zyrës së Komisionerit.

Gjatë vitit 2019, Zyra e Komisionerit ka përditësuar listën e autoriteteve publike, e cila këtë vit ka pësuar ndryshime për shkak të reformës së riorganizimit strukturor të organeve dhe institucioneve të administratës shtetërore. Nga monitorimi i kryer në fund të vitit 2019, rezultojnë 417 autoritete publike nga 525 në vitin 2018.

Ndërsa, nga monitorimi *online* i faqeve zyrtare të këtyre autoriteteve publike rezulton se:



Gjatë vitit 2019, pasqyrimi më i plotë i informacionit publik pa kërkesë në programin e transparencës evidentohet kryesisht në institucionet e reja të drejtësisë, si dhe në organet e vetëqeverisjes vendore. Sfidë mbetet ende krijimi, pasurimi dhe përditësimi i programit të transparencës me çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik. Kjo problematikë evidentohet veçanërisht, në ato autoritete publike të cilat kanë burime njerëzore dhe financiare të kufizuara, si dhe te ato që janë ende në fazë ristrukturimi.



Numri i autoriteteve publike të cilat kanë publikuar në faqet e tyre të internetit programin e transparencës është rritur krahasuar me vitin 2018, duke kaluar nga 42 në 60%. Kjo konfirmon prirjen pozitive të rritjes së transparencës së autoriteteve publike edhe pse në përmbajtjen dhe cilësinë e këtij informacioni ka ende shumë punë për të bërë.

2.1.1 Transparenca në administratën shtetërore dhe institucionet e pavarura

Zyra e Komisionerit për zgjedhje 30 autoritete publike (*kryesisht ministri dhe institucione të pavarura*) për të kryer një monitorim më të thelluar, në lidhje me kategoritë e informacionit që duhet të jenë pjesë e programit të transparencës.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni i detyrueshëm në përputhje me pikën 1, të nenit 7, të ligjit për të drejtën e informimit, sipas kategorive të mëposhtme:

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik” dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e

shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik.

Zyra e Komisionerit ka dalë me 30 Rekomandime për ministritë dhe institucionet e pavarura, të cilat do të jenë objekt monitorimi i vazhdueshëm.

2.1.2 Transparenca në njësitë e vetëqeverisjes vendore

Në lidhje me njësitë e vetëqeverisjes vendore, Zyra e Komisionerit konstatoi se niveli i transparencës ka shënuar përmirësim të ndjeshëm në krahasim me vitin 2018. Kryesisht, kjo i atribuohet miratimit të programit të ri model të transparencës për këto organe.

Ky program filloi të zbatohet nga 1 janari 2019. Vënia në zbatim e këtij instrumenti, fillimisht pati vështirësi për sa i përket plotësimit të të gjitha rubrikave me informacionet përkatëse. Kjo, për arsye se vetë funksionet, shërbimet dhe natyra e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore është shumë e gjerë.


Në monitorimin e parë të kryer në mars të vitit 2019, rezultoi se vetëm 5 njësi të vetëqeverisjes vendore vunë në zbatim programin e ri të transparencës në përputhje me modelin e miratuar. Bazuar në rezultatet e monitorimit, Zyra e Komisionerit në prill 2019, adresoi problematikën te këto njësi me qëllim përmbushjen e detyrimit për plotësimin e programit të transparencës sipas parashikimeve ligjore.

Në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për Informim”, Zyra e Komisionerit dhe Projekti STAR II, bashkëpunuan në shtator 2019, për kryerjen e një monitorimi më të detajuar mbi zbatueshmërinë e programit model të transparencës nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nga monitorimi *online* i faqeve zyrtare rezultoi se 44 kishin vënë në zbatim programin e transparencës. Ndërsa, pas monitorimit të kryer në dhjetor 2019, rezultoi se nga 61, 57 prej tyre kanë vënë në zbatim programin e transparencës. Në fund të vitit 2019, transparenca e njësive të vetëqeverisjes vendore paraqitet e përmirësuar, ku 94% e tyre kanë publikuar programin e transparencës, si dhe kanë përditësuar kategoritë e informacionit publik pa kërkesë.

2.2 Trajtimi i ankesave


Gjatë vitit 2019, pranë Zyrës së Komisionerit u depozituan 786 ankesa. Vlerësohet pozitive rritja e ankesave nga qytetarët në raport me grupet e tjera të interesit, si një tregues i ndërgjegjësimit të tyre mbi ushtrimin e të drejtës së informimit.

Ankesat për vitet 2016 - 2019



Nga numri total i ankesave, 553 janë zgjidhur pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit pranë autoriteteve publike. Për 18 ankesa, Komisioneri është shprehur me vendim. Nga numri i përgjithshëm 34 ankesa rezultuan jashtë afatit, 16 të paplota, 140 jashtë objektit të ligjit, 21 u trajtuan sipas kufizimeve të nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit dhe 28 ankesa u mbartën në vitin 2020. Gjatë vitit 2019 janë shqyrtuar edhe 24 ankesat e mbartura nga viti 2018.

Për vitin 2019, nga 786 ankesa



Problematikë e mbartur nga viti i kaluar vijon të mbetet kategoria e informacionit të kërkuar, i cili rezulton jashtë objektit të ligjit, si informacion/dokument që lidhen me proceset gjyqësore, administrative, akses në të dhënat personale apo informacion në lidhje me veprimtarinë e autoritetit publik.


Në procesin e shqyrtimit të ankesave dhe sidomos, nga zhvillimi i hetimeve administrative, në disa raste është evidentuar mungesë vullneti për dhënien e informacionit/dokumentacionit nga disa autoritete publike. Konkretisht, nuk bëhet një interpretim i saktë i kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të ligjit për të drejtën e informimit në raport me të drejtën e autorit, parimin e konfidencialitetit apo sekretit tregtar në fusha të tilla si trashëgimia kulturore, planifikimi dhe zhvillimi i territorit apo në sektorin e prokurimeve.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka marrë një sërë kërkesash për interpretim nga autoritetet publike të krijuara për shkak të reformës në drejtësi. Në veprimtarinë e tij, Komisioneri ka vlerësuar gjithmonë me prioritet transparencën në këtë proces, duke e konsideruar si një element shtesë për përmbushjen e pritshmërive të publikut nga kjo reformë.

2.3 Hetime administrative

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën për mbikëqyrjen dhe garantimin e të drejtës për akses në informacion publik, duke u mbështetur në vendosjen e balancës dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit.

Zyra e Komisionerit ka realizuar 85 hetime administrative në fushën e të drejtës për informim me synim verifikimin e ankesave të depozituara, si dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme. Janë dërguar pranë autoriteteve publike 304 kërkesa për parashtrime dhe u realizuan 28 seanca dëgjimore. Si përfundim, Komisioneri doli me vendim për 18 ankesa, prej të cilave 11 urdhërim për dhënie informacioni, 2 rrëzimi dhe 5 vendime me sanksion administrativ.



Problematikat e konstatuara rezultojnë të njëjta me vitin e kaluar:

- ✓ lëvizje të shpeshta të koordinatorit;
- ✓ koordinator në nivel ekzekutiv apo të ulët drejtues dhe akses i kufizuar në strukturat e tjera të autoritetit publik;
- ✓ delegimi i kërkesave për informacion në struktura të tjera të autoritetit, duke anashkaluar koordinatorin dhe procedurën e përcaktuar në ligj.

2.4 Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit (REKPD)

Zyra e Komisionerit ka vijuar punën me ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me përdorimin e “Regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (REKPD).

Për këtë qëllim u realizuan disa materiale promocionale, si dhe janë zhvilluar takime me karakter informues e trajnues.

Për shtrirjen e mëtejshëm të REKPDİ, Zyra e Komisionerit kërkoi nga institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore instalimin e tij. Përzgjedhja e këtyre autoriteteve është bërë për arsye të gamës së funksioneve, kategoritë e shërbimeve që ata ofrojnë dhe numrin e lartë të kërkesave që marrin. REKPDİ është funksional në 31 autoritete publike nga 27 në vitin 2018. Megjithatë, ecuria e shtrirjes së tij nuk është në nivelin e kërkuar, për shkak të mungesës së financimit. Deri tani ky proces është kryer vetëm me mbështetjen e donatorëve. Gjatë vitit 2019, numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nëpërmjet sistemit REKPDİ është 516. Për të njëjtën periudhë, numri i ankesave drejtuar Zyrës së Komisionerit nëpërmjet këtij “Regjistri” është 147.

2.5 Strategjitë Ndërsektoriale

Zyra e Komisionerit, si një institucion i cili ka në fokus nxitjen e transparencës dhe llogaridhënien e autoriteteve publike është pjesë e:

- ✓ Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2020 (SNRAP);
- ✓ Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK);
- ✓ Kontratës Sektoriale të Mbështetjes Buxhetore për Reformën në Administratën Publike 2015-2020 (SBS).

Në kuadër të zbatimit të këtyre dokumenteve strategjike, Zyra e Komisionerit raporton në mënyrë periodike mbi progresin e objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara në strategjitë përkatëse. Nga vetëdeklarimi i 128 autoriteteve publike, i dhënë në funksion të Kontratës Sektoriale të Mbështetjes Buxhetore për Reformën në Administratën Publike, rezulton se për vitin 2019 janë trajtuar 11758 kërkesa për informacion, nga të cilat 1185 nuk kanë marrë përgjigje. Përqindja e kërkesave për informacion të refuzuar përbën 10% të numrit total të kërkesave.

Në disa raste, Zyra e Komisionerit ka konstatuar mospërputhje midis shifrave të raportuara nga ana e autoriteteve publike me shifrat e pasqyruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve të autoritetit publik. Nga sqarimet e marra, është dalë në përfundimin se në disa raste autoritetet publike kanë regjistruar si kërkesa për informacion edhe kërkesat e qytetarëve lidhur me shërbime të ndryshme të ofruara nga autoriteti publik në kuadër të detyrave funksionale.

Në se do të analizonim 3 vitet e fundit, konstatohet se kemi një numër të konsiderueshëm kërkesash, që tregon se nga ana e autoriteteve publike ka një angazhim dhe vëmendje jo të vogël në lidhje me të drejtën për informim.

3. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Zyra e Komisionerit ka patur në fokus të veprimtarisë trajtimin e ankesave dhe hetimet administrative në fusha dhe sektorë të rëndësishëm për kategorinë dhe sasinë e të dhënave personale që përpunojnë apo ndikimin që kanë në privatësinë e individit. Gjatë vitit 2019 numri i ankesave të subjekteve të të dhënave personale rezultoi në rritje krahasuar me një vit më parë. Zyra e Komisionerit ka monitoruar zbatimin e rekomandimeve që janë dhënë për kontrollues publik dhe privat në periudhat paraardhëse të raportimit. Vëmendje iu kushtua kërkesave për transferim ndërkombëtar të të dhënave, në funksion të garantimit të sigurisë së tyre.


3.1 Trajtimi i ankesave

Për vitin 2019, pranë Zyrës së Komisionerit u regjistruan 301 ankesa në total. Nga shqyrtimi i tyre u konstatuan problematika si:

- mos garantimi i të drejtës për akses në të dhënat personale;
- detyrimi për korrigjim/fshirje i të dhënave personale;
- përpunimi i parregullt i të dhënave nga platformat online (elektronike);
- vendosja e sistemit të survejimit me kamera (CCTV) në ambiente publike dhe private/përhapja e paligjshme e imazheve të regjistruara;
- publikimi i të dhënave personale në media, kryesisht në ato online të regjistruara;
- marketingu i drejtpërdrejt në lidhje me komunikimet e pakërkuara, nëpërmjet telefonit ose postës elektronike.

Vlen të theksohet numri në rritje i ankesave të adresuara kundrejt mediave *online*. Zyra e Komisionerit ka ndërhyrë në ato raste kur ankesat kanë qenë brenda kompetencave të ligjit.

Ankesa në vite 2016 - 2019





3.2 Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Gjatë këtij viti janë kryer 142 inspektime në terren, në Tiranë dhe në gjithë territorin e vendit. Hetimet administrative janë realizuar me iniciativë nga Zyra e Komisionerit dhe si rezultat i trajtimit të ankesave të adresuara nga subjektet e të dhënave. Sektorët kryesorë ku janë realizuar

këto hetime janë institucione të administratës shtetërore, shëndetësi, call center, subjekte financiare jobankare, të transportit, etj.

Janë realizuar 67 hetime administrative në kontrollues publik dhe 75 në kontrollues privat, ose mbi bazë ankese 34 dhe me iniciativë nga vetë Zyra e Komisionerit 108.



Krahasuar me vitin 2018 duket sikur ka një rënie të numrit të hetimeve administrative në total, si rrjedhojë e faktit se këtë vit Zyra e Komisionerit është fokusuar më tepër në inspektimet në terren, çfarë ka rritur edhe numrin e inspektimeve në këtë drejtim nga 108 vitin e kaluar në 142 gjatë vitit 2019.

Inspektimet online të kryera gjatë vitit 2018 kanë shërbyer si shkak për hetimet administrative në terren për vitin 2019, në ato subjekte të cilat nuk zbatojnë kërkesat e nenit 18 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Zyra e Komisionerit trajtoi me prioritet inspektimet në institucione të administratës shtetërore dhe vlerëson reagimin e menjëhershëm të kontrolluesve për përmbushjen e detyrimeve ligjore. Problematikat kryesore të konstatuara gjatë hetimeve administrative janë:

- mungesa e masave teknike dhe organizative gjatë procesit të përpunimit, për të mbrojtur përhapjen e paligjshme të të dhënave personale, veçanërisht mungesa e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit;

- nevoja për të përmirësuar masat e sigurisë gjatë procesit të autentifikimit në portalet online;
- dërgimi i thirrjeve të pakërkuara telefonike ose dërgimi i mesazheve me postë elektronike nga ofrues të ndryshëm shërbimi (kontrollues), të cilët përmes komunikimit synojnë të ushtrojnë aktivitet promocional. Lind si domosdoshmëri për zgjidhjen e kësaj problematike hartimi i një kuadri ligjor të veçantë që do të bënte të mundur zgjidhjen aktuale dhe afatgjatë të këtij problemi;
- mbledhja, ruajtja dhe përpunimi i paligjshëm i të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV);
- tejkalimi i qëllimit dhe afateve të përpunimit të të dhënave personale;
- mungesa e rregullimit kontraktor në marrëdhëniet midis kontrolluesit dhe përpunuesit;
- mungesa e trajnimit të stafit që ka akses dhe përpunon të dhëna personale.


Në kuadër të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të viteve 2017-2018, Zyra e Komisionerit ka ushtruar hetime administrative në 11 kontrollues publik dhe privat. Hetimet u realizuan në rastet kur nuk ka pasur reagim në lidhje me përmbushjen e detyrimeve. Ndërkohë, pjesa më e madhe e kontrolluesve morën masa të menjëhershme për shkeljet e konstatuara. Pas ushtrimit të hetimeve administrative, janë zhvilluar 66 seanca dëgjimore, pas të cilave është dalë me aktet përkatëse nga Komisioneri.

3.3 Rekomandime dhe Urdhra

Komisioneri në zbatim të kompetencave që i jep ligji për mbrojtjen e të dhënave personale ka dalë me 39 Rekomandime për kontrollues publik dhe privat. Po ashtu, Komisioneri u shpreh me 2 Urdhra, mbi ndërprerjen dhe shkatërrimin e përpunimit të të dhënave imazhe-video, si dhe garantim e të drejtës së aksesit për subjektet e të dhënave. Këto të fundit u zbatuan në mënyrë të menjëhershme nga kontrolluesit.

3.4 Sanksione administrative

Zyra e Komisionerit pas ushtrimit të hetimeve administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm publik dhe privat, kryesisht ose mbi bazë ankese të subjekteve të të dhënave ka vendosur masë administrative, kjo në rastet kur shkeljet kanë qenë serioze dhe të përsëritura. Në përfundim, Komisioneri doli me 20 vendime, të cilat përmbajnë 56 sanksione administrative.




Shkeljet e kontrolluesve të sanksionuar administrativisht konsistojnë, ndër të tjera, në mungesën e plotësimit të detyrimit për njoftim, ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale,

mungesën e politikave të privatësisë me qëllim informimin e subjekteve, mosrespektimin e rregullave të të dhënave personale gjatë përpunimit në platformat online, dërgimin e thirrjeve të pakërkuara, etj. Është për t'u theksuar fakti që reagimi i kontrolluesve ka qenë pozitiv në tërësi, duke ndërmarrë masat e nevojshme për të garantuar privatësinë e individëve në zbatim të detyrimeve ligjore përkatëse.

Gjatë këtij viti i është kushtuar rëndësi edhe rolit të personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale pranë kontrolluesve, që është element i rëndësishëm edhe në referim të Rregullores së Bashkimit Evropian 679/2016 (GDPR). Forcimi i rolit të personit të kontaktit do të jetë në vëmendje të Zyrës së Komisionerit edhe gjatë vitit 2020. Personi i kontaktit është një hallkë në procesin e garantimit të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të nenit 27 të ligjit dhe Udhëzimit të Komisionerit nr. 47, datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”. Mos marrja e masave të sigurisë nga ana e kontrolluesve publik dhe privat përbën kundërvajtje administrative.

3.5 Njoftimi

Në përmbushje të detyrimit ligjor gjatë këtij viti, kanë njoftuar 179 subjekte kontrolluese. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë ka arritur në 5691. Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese është 5620. Përgjegjësia për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit të kontrolluesve të cilët përpunojnë të dhëna personale ka pësuar rritje.



3.6 Transferimi ndërkombëtar

Objektiv i Zyrës së Komisionerit është edhe garantimi i përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm i të dhënave personale të individëve në rastet kur këto të dhëna përpunohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2019, janë trajtuar 16 praktika për autorizimin e transferimit në shtete pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe është dalë me 1 vendim për lejimin e transferimit ndërkombëtar në sektorin bankar. Në rastet e tjera, nuk ka qenë e nevojshme pajisja me autorizim nga ana e Zyrës së Komisionerit, kontrolluesit janë orientuar dhe udhëzuar me qëllim zbatimin sa më të drejtë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Theksojmë se duke u nisur nga Formulari i Njoftimit të kontrolluesve, në rastet ku është konstatuar se realizohet transferim në vende me nivel jo të mjaftueshëm, janë kryer hetime administrative.

4. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

4.1 Hartimi i akteve ligjore


Për vitin 2019, në përmbushje të rekomandimeve që burojnë nga detyrime ndërkombëtare u hartuan:

- projektligji “Për ratifikimin e Protokollit që ndryshon Konventën për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”;
- projektligji “Për aderimin në Konventën 205 “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”;
- projektligji “Mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Projektligjet e sipërcituara janë hartuar nga Zyra e Komisionerit në cilësinë e institucionit kontribuues në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare, si dhe në kuadër të procesit të integritetit të vendit. Këto projektakte janë depozituar pranë ministrive përgjegjëse në cilësinë e institucioneve propozuese për të vijuar me procesin e miratimit të tyre.

4.2 Dhënie mendimi për projektakte

Bazuar në germën a), të pikës 1, të nenit 31 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit ka dhënë mendim për 13 projekt akte normative, përfshirë këtu, projektligje, projektvendime dhe projekt marrëveshje. Gjithashtu, janë dhënë 116 mendime dhe opinione ligjore të paraqitura nga kontrollues publik e privat.



4.3 Proceset gjyqësore

Në total për këtë vit, për sa i përket të drejtës së informimit, janë ndjekur 15 procese gjyqësore, ndër të cilat 4 për vendime të dhëna në vitin 2019, 6 janë ndjekur për akte administrative dhe 5 procese janë të mbartura nga viti 2018.

Nga 15 procese gjyqësore, gjykata ka vendosur për 8 çështje lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit, 1 pranimin e kërkesë padisë, 1 pushimin e çështjes, ndërsa 5 çështje vijojnë të jenë në proces.

<i>E DREJTA PËR INFORMIM</i>	
<i>Viti</i>	2019
<i>Procese Gjyqësore</i>	15
<i>Rrëzimin e padisë</i>	8
<i>Pranim të padisë</i>	1
<i>Pushim të procesit gjyqësor</i>	1
<i>Vijon procesi gjyqësor</i>	5

Komisioneri për vitin 2019 në respektim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, është shprehur me 20 vendime. Ndër to, për 8 vendime kontrolluesit kanë ekzekutuar vullnetarisht sanksionet administrative, për 11 Zyra e Komisionerit ka kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm, ndërsa 1 vendim mbetet në pritje të plotësimit të afatit.

Në total për këtë vit për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, janë ndjekur 15 procese gjyqësore. Ndër to, 7 procese gjyqësore për vendime të dhëna në vitin 2019, 2 janë ndjekur për akte administrative, 5 për vendime të dhëna në vitin 2018 dhe 1 çështje është në proces.

Për 13 çështje gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të Komisionerit dhe 2 çështje janë pushuar.

<i>MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE</i>	
<i>Viti</i>	2019
<i>Ekzekutime vullnetare</i>	8
<i>Ekzekutime të detyrueshme</i>	11
<i>Në afat për të ekzekutuar vullnetarisht</i>	1
<i>Procese Gjyqësore</i>	15
<i>Rrëzimin e kërkesëpadisë</i>	13
<i>Pushim të procesit gjyqësor</i>	2

Gjatë vitit 2019, Zyra e Komisionerit ka ndjekur edhe proceset gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit. Numri total i proceseve gjyqësore pranë kësaj gjykate është 27 çështje, ndër të cilat, 23 vijojnë të jenë në proces, për 3 çështje Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë duke konfirmuar vendimmarrjen e Komisionerit dhe për 1 çështje vendosi prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

5. BASHKËPUNIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

5.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar, ndërinstitutional dhe me shoqërinë civile.

5.1.1 Marrëdhënia me EUROJUST

Në datën 1 nëntor 2019 hyri në fuqi Marrëveshja për Bashkëpunim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust, duke finalizuar me sukses një proces që ka zgjatur prej disa vitesh. Kjo u bë e mundur nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitutional midis Prokurorisë së Përgjithshme, Zyrës së Komisionerit dhe Ministrisë së Drejtësisë në rolin koordinues e nënshkrues të Marrëveshjes, me mbështetjen e Projektit IPA/2017 “Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor”.

Një nga kushtet kryesore të Marrëveshjes së nënshkruar midis palëve ishte garantimi i nivelit të mjaftueshëm i mbrojtjes për të dhënat personale gjatë shkëmbimit të informacionit hetimor në kuadër të luftës kundër krimeve të rënda, veçanërisht, krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Marrëveshja u finalizua me zbatimin e Planveprimit midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Zyrës së Komisionerit, nënshkruar në datën 25.02.2019. Në zbatim të këtij Planveprimi, u zhvilluan vizita monitoruese pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të disa rrethëve kryesore gjyqësore dhe u hartuan rekomandime me problematikat dhe sugjerimet përkatëse për marrjen e masave konkrete nga ana e organeve të përfshira në proces, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pas përmbushjes me sukses të këtyre rekomandimeve nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme, u realizua misioni përfundimtar monitorues i ekspertëve të Eurojust, i cili rezultoi me një raport vlerësimi pozitiv duke u pasuar me pranimin zyrtarisht të Shqipërisë në Eurojust, që konsiderohet një sukses i madh në fushën e bashkëpunimit të drejtësisë penale.

Në zbatim të nenit 19 të Marrëveshjes Zyra e Komisionerit do të vijojë të ketë një rol të rëndësishëm, pasi do të monitorojë zbatimin e detyrimeve lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe në bashkëpunim me Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Eurojust do të hartojë raportin vjetor për Komisionin Evropian.

5.1.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Zyra e Komisionerit ka qenë në qendër të vëmendjes për sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar për arsye të organizimit të aktivitetit më të rëndësishëm botëror në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë. *(Për më shumë Aneksi 1)*

Gjithashtu, gjatë këtij viti Zyra e Komisionerit ka qenë aktive në takimet e zhvilluara nga organizmat ndërkombëtar si Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave Personale (EDPB), Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës (TPD) dhe Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit - IWGDPT).

5.1.3 Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, Zyra e Komisionerit:

- Nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me shoqatën Together for Life në kuadër të zhvillimit të projektit “MATRA for European Cooperation Embassy Program 2020”, që ka për qëllim asistencën e ndërsjellë në rritjen e transparencës në fushën e shëndetësisë, hartimin e indeksit të transparencës për institucionet e shëndetësisë si dhe programeve të transparencës të dedikuara për fushën e shëndetësisë.
- Zhvilloi aktivitetin me temë “Transparenca e institucioneve të arsimit të lartë”, me studentë që përfaqësojnë organizatën Qëndresa Qytetare. Në fokus të tij ishte njohja me legjislacionin dhe funksionet e Zyrës së Komisionerit.
- Zhvilloi një cikël trajnues mbi të drejtën e informimit me aktivistë të shoqatës “Romano Kham”, në kuadër të projektit “Edukimi dhe Fuqizimi i Komunitetit Rom përmes të Drejtës së Informimit për të Aksesuar Sistemin e Drejtësisë”.
- Bashkëpunoi me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të projektit “Pjesëmarrja e Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC) në vendimmarrje në Shqipëri”.
- Zhvilloi takime për të drejtën e informimit me përfaqësues të shoqërisë civile në Tiranë, Elbasan e Librazhd. Pjesë e tyre ishte edhe njohja me fushatën ndërgjegjëse “Pyet Shtetin – Merr Përgjigje”, për përdorimin e REKPDI.
- Zhvilloi një takim paraprak në kuadër të pjesëmarrjes në projektin “Zhvillimi i kapaciteteve, bashkëpunimit dhe kulturës së mbikëqyrjes të sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut (DECOS) 2019-2022” të Qendrës Evropiane për Studimet e Sigurisë (CESS). Projekti synon fuqizimin e parlamenteve, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të sistemit në mbikëqyrjen demokratike të sektorit të sigurisë.

Zyra e Komisionerit bashkëpunon dhe konsulton rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile dhe e reflekton atë në të gjithë veprimtarinë e saj.

5.2 Trajnime

Për zgjerimin e njohurive të stafit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit zhvilloi trajnime me ekspertë të huaj, me tematikat:

- “Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave dhe kodet e sjelljes sipas Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE (GDPR)”;
- “Si organizatat i administrojnë në mënyrë të përgjegjshme të dhënat personale”.

Si një nga aktivitetet e projektit të binjakëzimit “Antikorrupsion Shqipëri-BE”, në Zyrën e Komisionerit u zhvillua trajnimi me temë “Asistencë në përmirësimin e intolerancës ndaj

korupsionit përmes ndërgjegjësimit dhe inkurajimi për bashkëpunim me shoqërinë civile” me ekspertë të huaj.


Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka vijuar veprimtarinë trajnuese për forcimin e kapaciteteve të koordinatorëve të të drejtës për informim të institucioneve qendrore dhe të pavarura për përdorimin e REKPD.

5.3 Aktivitete të tjera

Me rastin e 28 Janarit – Ditës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit prezantoi nismën “Luaj dhe mëso – Happy Onlife”, e cila ka si qëllim ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të fëmijët.

Me rastin e 28 Shtatorit - Ditës Ndërkombëtare të të Drejtës për Informim, Zyra e Komisionerit, si pjesë e aktiviteteve ndërgjegjëse për nxitjen e llogaridhënies dhe transparencës së autoriteteve publike, ftoi qytetarët për të përdorur “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve të të drejtës për informim”, që funksionon si pjesë e portalit *pyetshtetin.al*.

Gjatë vitit 2019, u publikuan numrat 7 dhe 8 të Revistës “Informim Dhe Privatësi”, botime ku pasqyrohen aktivitetet kryesore të Zyrës së Komisionerit.



6. MENAXHIMI BUXHETOR

6.1 Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Administrimi dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, në përputhje me objektivat e strategjisë dhe programin e punës së Zyrës së Komisionerit për vitin 2019, është fokusuar dhe orientuar drejt rritjes profesionale dhe ekspertizës së stafit. Strategjia e ndjekur ka nxitur garën profesionale dhe ka shërbyer si instrument për identifikimin dhe administrimin më të mirë të burimeve njerëzore.

Në zbatim të Planit Vjetor të Trajnimeve, punonjësit e Zyrës së Komisionerit kanë qenë pjesëmarrës në trajnimet e organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA). Gjithashtu, stafi ka marrë pjesë edhe në trajnime të organizuara nga organizata publike/jopublike vendase ose të huaja, duke bërë të mundur shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikatat më të mira. Janë trajnuar dhe certifikuar 22 punonjës, në 17 tematika të ndryshme. Trajnimet kanë ndikuar direkt në rritjen profesionale, duke garantuar efektivitet në funksionimin dhe veprimtarinë e të gjitha strukturave.

6.2 Struktura Organizative

Struktura e Zyrës së Komisionerit është miratuar me Vendimin nr. 86/2018 “Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Klasifikimin e Pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të Kuvendit të Republikës të Shqipërisë dhe përbëhet nga 37 punonjës.

Zyra e Komisionerit paraqet një strukturë të qëndrueshme, por ka nevojë të plotësohet me numrin e nevojshëm, fakt i evidentuar në Raportin e Shtetit të Komisionit Evropian nga viti 2016 në mënyrë të përvitshme, kërkesë kjo e paraqitur çdo vit në hartimin e projektbuxhetit. Numri i punonjësve vazhdon të mbetet i pamjaftueshëm për mbulimin e veprimtarisë kryesore të Zyrës së Komisionerit, por edhe të kompetencave dhe detyrave të shtuara me ligje të veçanta.

6.3 Të ardhurat dhe shpenzimet

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2019, Zyra e Komisionerit ka shpenzuar vlerën buxhetore 83.435 (në mijë lekë). Në kuadër të realizimit të fondeve të vëna në dispozicion, në përmbushje të misionit dhe objektivave institucionalë, janë marrë masat për ndjekjen, rishpërndarjen e fondeve buxhetore drejt orientimit të prioritetëve, duke garantuar efektivitetin e përdorimit të fondeve publike, në respektim të parimeve dhe rregullave të menaxhimit financiar. Është realizuar buxheti në tërësinë e tij në masën 98.4%, kundrejt planit vjetor. Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet në përqindje çdo kategori shpenzimesh, përkundëjt totalit të buxhetit, si dhe realizimi në përqindje dhe vlerë i secilës kategori shpenzimesh, përkundëjt buxhetit të akorduar.

TABELA E AKORDIMIT TË BUXHETIT DHE REALIZIMIT

VITI 2019				000 / lekë	
Nr.	EMËRTIMI	PLAN	% kundrejt totalit	Fakt 12 mujor	% realizimi kundrejt planit vjetor
1	Paga	40.615	48%	40.605	99.9%
2	Sigurime shoqërore	6.685	8%	6.669	99.7%
3	Mallra e shërbime të tjera	21.060	24.8%	20.215	96%
4	Investime	16.000	18.8%	15.570	97.3%
5	Transferta te buxhetet familjare	300	0.3%	300	100%
6	Kuotizacion	100	0.1%	76	76%
	Totali	84.760	100%	83.435	98.4%

Pjesën kryesore të shpenzimeve e zënë pagat e personelit, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Fondi i përgjithshëm i pagave është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 40.605 (në mijë) lekë, ose 99.9% dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 6.669 (në mijë) lekë, ose 99.7% e planifikimit për vitin 2019.

Fondi i akorduar për shpenzime korrente të tjera është realizuar në vlerën 20.591 (në mijë) lekë, ose 96% e fondit të planifikuar. Shpenzimet e domosdoshme të planifikuara dhe të miratuara kanë gjetur realizim, sipas nevojave konkrete të institucionit dhe projekteve të miratuara për investimet, realizim i cili është në vlerën 15.570 (në mijë) lekë, ose 97.3% e fondit të planifikuar për këtë zë shpenzimi.

6.4 Të ardhurat nga sanksionet

Për vitin 2019, Zyra e Komisionerit arkëtoi të ardhura nga sanksionet administrative, për shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi. Sanksionet arkëtohen në masën 100% në buxhetin e shtetit dhe janë shlyer vullnetarisht ose me ekzekutim të detyrueshëm. Për vitin 2019, sanksionet e vendosura janë në shumën 5 310 (në mijë lekë), nga të cilat vlera e arkëtuar është 2 895 (në mijë lekë). Gjatë këtij viti është arkëtuar edhe shuma 1 478 (në mijë) lekë, për sanksione të vendosura në periudhën 2016-2018. Shuma totale e arkëtuar nga sanksionet administrative për vitin 2019 është 4 373 (në mijë lekë).

Totali i Sanksioneve në Vitin 2019	5 310 (në mijë lekë)
Për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 9887/2008, i ndryshuar	4 560 (në mijë lekë)
Për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 119/2014.	750 (në mijë lekë)

7. PROGRES RAPORTI I BE PËR SHQIPËRINË MBI ZYRËN E KOMISIONERIT

1. *Për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, kapacitetet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale duhet të jenë të përshtatshme për të kryer në mënyrë efektive detyrat e tij.*

Detyrë e Zyrës së Komisionerit, mbetet zhvillimi i trajnimeve për mbrojtjen e të dhënave personale të cilat realizohen me mbështetjen e programeve IPA dhe TAIEK apo edhe aktiviteteve trajnuese që realizohen brenda dhe jashtë Zyrës së Komisionerit. Bërja e strukturës së përshtatshme në raport me kryerjen në mënyrë të efektshme të detyrave nuk varet nga vetë Zyra e Komisionerit, por është detyrë e institucioneve që miratojnë numrin e punonjësve dhe fondet buxhetore. Në Raportet e Shtetit të Komisionit Evropian theksohet shtimi i kapaciteteve për Zyrën e Komisionerit me numër punonjësish dhe në buxhet.

2. *Përpyekjet e mëtejshme janë të nevojshme për të harmonizuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave 679/2016 dhe Direktivën e Policisë 680/2016.*

Zyra e Komisionerit është përfituese nga programi i Bashkimit Evropian IPA 2017 e projektit të binjakëzimit “Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me *acquis* të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave”, me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR) dhe Direktivën e Policisë. Deri në fillimin e projektit, i cili pritet të fillojë zbatimin në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2020, Zyra e Komisionerit ka iniciuar punën për ndryshimet ligjore në raport me këto dy akte.

3. *Shqipëria ende nuk ka nënshkruar apo ratifikuar Protokollin e vitit 2018 që ndryshon Konventën për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se ratifikimi i Protokollit që ndryshon Konventën 108 është një detyrim i rëndësishëm si vend anëtar i Këshillit të Evropës, për të përmbushur dhe plotësuar legjislacionin në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Zyra e Komisionerit ka hartuar projektligjin për ratifikimin e Protokollit që ndryshon Konventën për Mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, i cili është depozituar pranë Ministrisë së Drejtësisë në cilësinë e institucionit propozues gjatë vitit 2019, për të vijuar me tej procedurën e miratimit.

4. *Vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit nuk janë të detyrueshme për zyrtarët e administratës publike.*

Ky rekomandim është konstatuar si problematikë edhe gjatë veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit dhe është reflektuar në projektligjin e hartuar për ndryshimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke e kthyer vendimin e Komisionerit në titull ekzekutiv.

8. PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE

8.1 Procesi *screening*

Zyra e Komisionerit është pjesë e Kapitullit “Kriteri Politik”, Kapitullit 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”, si dhe Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 94/2019.

- Si pjesë e Kapitullit 23, ku Zyra e Komisionerit ka kontribut të drejtpërdrejtë si kapitulli për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ka bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë në cilësinë e institucioni lider. Gjithashtu, në kuadër të procesit *screening* me ekspertët e EURALIUS dhe GIZ ka dhënë kontribut në plotësimin e Tabelës së Analizës së Akteve Komunitare (LGA), Kapaciteteve Administrative, si dhe Tabelave të Përputhshmërisë (ToC) për aktet përkatëse lidhur me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
- Si pjesë e Kapitullit 24, Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me Ministrinë e Brendshme duke dhënë kontribut në plotësimin e ToC, sa i përket akteve pjesë e këtij kapitulli që kanë pikë prerje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
- Si pjesë e Kapitullit 10, Zyra e Komisionerit ka hartuar projektligjin “Mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i cili transponon Direktivën 2003/98/EC “Mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, e ndryshuar me Direktivën 2013/37/EU. Në vijim, me marrjen dijeni nga Komisioni Evropian për miratimin e Direktivës së re të BE 2019/1024 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, me rekomandim të tyre, Zyra e Komisionerit po bashkëpunon me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e institucionit propozues, për hartimin e projektligjit me ndryshimet që sjell direktiva e re e miratuar.

8.2 Projekti i binjakëzimit

Zyra e Komisionerit është përfituese nga programi i Bashkimit Evropian IPA 2017, e projektit të binjakëzimit *“Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me acquis të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave”*. Objekti i këtij projekti është përafrimi i legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian, e konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR) dhe Direktivën e Policisë. Ky projekt është ende në fazën fillestare. Është përgatitur projekt fisha nga Zyra e Komisionerit e cila aktualisht është në proces miratimi nga Komisioni Evropian, pas të cilit pritet zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe fillimi i zbatimit të projektit në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2020. Ndërkohë, Njësia Drejtuese IPA pranë Zyrës së Komisionerit ka ndjekur dhe plotësuar të gjitha detyrimet në raport me institucionet e tjera.

8.3 Raportime

Zyra e Komisionerit ka dhënë kontribut në hartimin e:

- raportit për Ministrinë e Evropës dhe Punët e Jashtme mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për vitin 2018 dhe tremujorin e parë të vitit 2019, në kuadër të takimit të 11-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”;
- raportit mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për periudhën 1 janar-31 tetor 2019, si dhe të dhëna statistikore për vitin 2018, në kuadër të hartimit të kontributit të parë të qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020;
- raportit në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022, për Kapitullin 23 dhe Kapitullin 10, mbi planifikimin e akteve ligjore dhe dokumenteve strategjike që synojnë përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- raportit periodik në kuadër të pjesëmarrjes në Grupin e Berlinit;
- gjashtë raporte katër-mujore në zbatim të Vendimit nr. 134/2018 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, tre në funksion të zbatimit të rezolutës së Kuvendit dhe tre për rekomandimet e Komisionerit.

9. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT 2019

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kërkoi për vitin 2019 nga Zyra e Komisionerit:

1. *Të thellojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, mbi planin tematik, duke synuar rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesin në informacion”.*

“Realizuar plotësisht” - Në kuadër të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin *online* në faqet zyrtare të institucioneve të pavarura dhe ministrive, me objekt verifikimin e zbatimit të programit të transparencës. Në vijim të këtij monitorimi, Komisioneri doli me 30 Rekomandime.

2. *Të monitorojë përditësimin e programeve të transparencës dhe regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, nga autoritetet publike, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit vendor;*

“Realizuar plotësisht” - Zyra e Komisionerit ka përditësuar listën e Autoriteteve Publike të cilat rezultojnë të jenë 417 krahasuar me 525 në vitin 2018. Nga monitorimi i kryer ka rezultuar se 246 autoritete publike kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare programin e transparencës, 189 kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve dhe 236 kanë publikuar kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit. Sa i përket pushtetit vendor, nga monitorimi i kryer në fund të muajit dhjetor rezulton se 57 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë publikuar programin e ri të transparencës. Për sa i përket ministrive, veprimtaria monitoruese dhe mbikëqyrëse e Zyrës së Komisionerit lidhur me to është pasqyruar në pikën 1 më sipër.

3. *Të investohet për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e mëtejshme të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit, që administrohet nga autoritetet publike.*

“Realizuar plotësisht” – Zyra e Komisionerit është pjesë e Kontratës Sektoriale të Mbështetjes Buxhetore për Reformën në Administratën Publike, ku mbulon indikatorin për përmirësimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit. Pavarësisht përmbushjes së indikatorit në masën e kërkuar dhe lëvrimit të transheve nga Komisioni Evropian për buxhetin e shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk e ka konsideruar prioritet lëvrimin e fondeve për Zyrën e Komisionerit. Fondet që do të përfitoheshin nga suporti buxhetor, do të përdroreshin nga ana e Zyrës së Komisionerit për instalimin e REKPDË në të gjitha Autoritetet Publike.

Në mungesë të fondeve, Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me donatorë duke bërë të mundur fillimisht instalimin e REKPDË në 27 Autoritete Publike. Gjithashtu gjatë vitit 2019 Zyra e Komisionerit kërkoi nga Autoritetet Publike (institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore) shtrirjen e mëtejshme të REKPDË me fondet e tyre. Në përgjigje të kërkesës së Zyrës së Komisionerit, REKPDË u shtua me 4 Autoritete Publike duke e çuar

në 31 numrin e përgjithshëm. Megjithatë, ecuria e shtrirjes së tij nuk është në nivelin e kërkuar, për shkak të mungesës së burimeve financiare të këtyre autoriteteve publike.

4. *Të zhvillohet mbi plan tematik procesi i monitorimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke synuar minimizimin e shkeljeve të ligjit, respektimin e privatësisë dhe përpunimin e drejtë e të ligjshëm të të dhënave personale;*

“Realizuar plotësisht” - Për këtë periudhë janë trajtuar 301 ankesa të paraqitura nga subjektet e të dhënave personale. Janë kryer 142 inspektime, ndër këto 108 inspektime mbi plan tematik në sektorët e administratës shtetërore, fushën e shëndetësisë (*spitale rajonale dhe private-klinika private*), fushën e transportit (*agjenci në fushën e transportit*), call center, si dhe 34 inspektime mbi bazë ankese. Krahasuar me vitin 2018 Zyra e Komisionerit ka rritur numrin e inspektimeve mbi plan tematik duke e çuar në 108, nga 80 inspektime kryesisht të kryera në total për vitin 2018.

5. *Të mbikëqyrë kontrolluesit publikë dhe privatë mbi zbatimin e detyrimit për informim të subjekteve të të dhënave, në lidhje me të drejtat e tyre, qëllimin e përpunimit, publikimin e politikave të privatësisë në faqet e tyre online;*

“Realizuar plotësisht”- Zyra e Komisionerit ka kryer inspektime me qëllim mbikëqyrjen e kontrollueseve publikë dhe privatë. Për kontrolluesit publikë, objekti i inspektimit ka qenë zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me fokus të veçantë publikimin e politikave të privatësisë në faqet e tyre *online*. Gjithashtu janë kryer inspektime në kontrollues privatë në sektorët e cituar si më sipër, me objekt zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, qëllimin e përpunimit, detyrimin për informim të subjekteve të të dhënave si dhe ruajtjen e sigurinë e tyre. Në përfundim të këtyre inspektimeve Zyra e Komisionerit doli me 39 Rekomandime, 20 vendime me 56 sanksione administrative dhe 2 Urdhra për kontrolluesit publikë dhe privatë.

6. *Të rrisë numrin e masave administrative për shkelje ligjore të konstatuara, me fokus të veçantë mungesën e programeve të transparencës dhe regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;*

“Realizuar plotësisht”- Zyra e Komisionerit ka zhvilluar një proces monitorimi të detajuar të programeve të transparencës dhe regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të Autoriteteve Publike. Në përfundim të këtij procesi, Zyra e Komisionerit ka dalë me 30 Rekomandime për autoritetet publike, duke i lënë një afat kohor prej 90 ditësh për zbatimin e tyre.

7. *Të përfshihet për të pasur rol aktiv në rregullimin e veprimtarisë së medias online, duke siguruar informacion publik proaktiv nga autoritetet publike, në respekt dhe garantim të parimeve dhe legjislacionit për privatësinë;*

“Realizuar plotësisht” - Zyra e Komisionerit ka luajtur rol aktiv në lidhje me këtë rekomandim duke ndërhyrë në rastet kur ankesat e adresuara kundrejt mediave online, kanë

qenë të legjitimuara. Me marrjen në shqyrtim të ankesave, Zyra e Komisionerit i është drejtuar mediave apo portaleve për verifikimin e ligjshmërisë së sigurimit të pamjeve video, si dhe publikimit në faqet e tyre online. Për këto raste, nga ana e kontrolluesëve (media/portale) të regjistruar, pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit ka patuar një reagim pozitiv duke hequr pamjet video të ngjarjes apo duke fshirë lajmin. Objekt i këtyre ankesave ka qenë:

- fshirja e të dhënave në portalet online;
 - fshirja e videove të marra nga sistemi i CCTV të banesës së personit dhe të publikuara në media online;
 - publikimi i të dhënave personale personale në artikuj të portaleve online.
8. *Të forcojë marrëdhëniet bashkëpunuese me partnerët ndërkombëtarë, në përmbushje të angazhimeve të marra në kuadër të projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë përmirësimin e dy fushave të veprimtarisë së institucionit dhe organizimin e trajnimeve;*

“Realizuar plotësisht” – Zyra e Komisionerit ka qenë në qendër të vëmendjes për sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, për arsye të organizimit të aktivitetit më të rëndësishëm botëror në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë.

9. *Të vijojë të luajë rol aktiv në favor të proceseve integruese të vendit, në përmbushje të funksionit të anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Privatësisë ICDPPC, si dhe atij të vëzhguesit në Bordin Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale;*

“Realizuar plotësisht” - Në cilësinë e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare (ExCo-ICDPPC), Zyra e Komisionerit ka bashkëudhëhequr procesin e organizimit të edicionit të 41-të të saj, të zhvilluar në Tiranë në 21-24 tetor 2019. Në cilësinë e anëtarit vëzhgues në Bordin Evropian (EDPB) ka ndjekur rregullisht takimet dhe diskutimet e zhvilluara në këtë forum.

10. *Të asistojë në hartimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe nënligjor, me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me legjislacionin përkatës të BE, konkretisht me Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) dhe Direktivën (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (Direktiva për mbrojtjen e të dhënave të personave fizikë gjatë procesit penal);*

“Realizuar plotësisht” - Në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) dhe Direktivën e Policisë, Zyra e Komisionerit ka kryer të gjithë punën përgatitore dhe procedurat që duhet të ndiqen për realizimin projektit të binjakëzimit i cili ka si objekt

përafrimin e legjislationit të brendshëm me aktet e sipërcituara. Ky projekt pritet të fillojë gjashtë mujorin e dytë të vitit 2020.

11. *Të intensifikojë dhe të nxisë punën në përmbushjen e plotë të detyrimeve ndërkombëtare mbi ratifikimin dhe nënshkrimin e Protokollit Shtesë të Konventës 108 “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale”;*

“Realizuar plotësisht” - Zyra e Komisionerit ka hartuar projektligjin “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës 108 “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale”. Lidhur me këtë akt është kryer një analizë ligjore sa i përket Protokollit ndryshues të Konventës 108 në raport me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës 108 “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale”, është dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë në cilësinë e institucionit propozues për të vijuar procedurat e miratimit të tij.

12. *Të vijojë aktivitetet informuese e sensibilizuese mbi edukimin e të rinjve për të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në ambientet digjitale.*

“Realizuar plotësisht” - Në kuadër të aktiviteteve ndërgjegjësuere me të rinjtë, janë zhvilluar takime/trajnime për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në disa Institucione të Arsimit të Lartë (publik e privat) në Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë më shumë se 200 persona. Zyra e Komisionerit ka zhvilluar fushatën “*Luaj dhe mëso – Happy Onlife*”, në gjashtë shkolla 9-vjeçare të Tiranës me qëllim ndërgjegjësimin për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedisin digjital të grup moshës 8-14 vjeç. Në këto takime kanë marrë pjesë më shumë se 150 fëmijë. Ky projekt do të shtrihet edhe më gjerë duke zhvilluar iniciativën “*Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy Onlife*” edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

10. NEVOJA PËR NDRYSHIME NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT

10.1 Përafrimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Direktivën e Policisë.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian, prioritet mbetet nevoja për të përafruar legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale me atë të *Acquis Communautaire*. Kuadri ligjor i mbrojtjes së të dhënave personale ndodhet para një revolucioni të madh për efekt të reformës evropiane, për shkak të hyrjes në fuqi të Rregullores 679/2016 dhe Direktivës 680/2016, si dhe modernizimit të Konventës 108. Me finalizimin e ndryshimeve ligjore do të përgatitet edhe kuadri nënligjor në zbatim të tyre. Në përmbushje dhe realizim të PKIE 2020-2022, është parashikuar miratimi i ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe përafrimi me Rregulloren 679/2016 dhe Direktivën 680/2016 në tre mujorin e katërt të vitit 2021.

10.2 Miratimi i projektligjit “Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” në kuadër të transpozimit të Direktivës së BE 2019/1024

Zyra e Komisionerit ka evidentuar nevojën e përmbushjes së pjesës së munguar të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, duke mundësuar ripërdorimin e dokumenteve të bëra publike më shumë se një herë nga ana e organeve të sektorit publik. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson të rëndësishme miratimin e projektligjit “Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i cili do të transpozojë Direktivën e BE 2019/1024.

10.3 Miratimi i projektligjit “Për thirrjet e pakërkuara”

Si rezultat i ankesave të shpeshta pranë Zyrës së Komisionerit lidhur me shqetësimin e marrjes së telefonatave të pakërkuara nga ofrues të ndryshëm shërbimi, të cilët përmes komunikimit synojnë të ushtrojnë aktivitetet promociional, Zyra e Komisionerit sheh të domosdoshme hartimin e projektligjit për thirrjet e pakërkuara. Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i regjistrit të komunikimeve tregtare të pakërkuara, si dhe përcaktimi i rregullave për përdorimin, aksesimin, administrimin dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

11. VIZIONI I INSTITUCIONIT

Vizioni i Zyrës së Komisionerit është forcimi i partneritetit me qytetarët në garantimin e të drejtave të tyre kushtetuese, si dhe vendosja e urave të bashkëpunimit me kontrolluesit dhe autoritetet publike për përmirësimin e zbatimit të këtyre të drejtave.

Për përmbushjen e sa më sipër, gjatë vitit 2020, objektivat e Zyrës së Komisionerit do të jenë:

- përafrimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian (Konventa 108+, Rregullorja 679/2016, Direktiva 680/2016);
- masa konkrete në lidhje me thirrjet e pakërkuara telefonike ose dërgimit të mesazheve me postë elektronike;
- mbikëqyrja e kontrolluesve në fushën e shëndetësisë dhe atë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- rishikimi i programit model të transparencës dhe modelit të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;
- shtrirja e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve;
- forcimi i rolit dhe kapaciteteve të koordinatorit të të drejtës për informim;
- aktivitete ndërgjegjëse dhe trajnuese të Zyrës së Komisionerit në kuadër të fushave të veprimtarisë për informimin dhe ndërgjegjësimin për të drejtat dhe detyrimet.

Po aq e rëndësishme sa përmbushja e objektivave të listuara më sipër, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse pasqyrim i misionit dhe vizionit të Zyrës së Komisionerit, është e rëndësishme rritja e perceptimit pozitiv të të gjithë përdoruesve të legjislacionit që autoriteti ka në përmasat e veprimtarisë së tij. Në këto vite, Zyra e Komisionerit ka shkelur nëpër terrene të reja dhe të paprekura më parë, duke u përpjekur të krijojë praktika të konsoliduara dhe të vlefshme për përdoruesit e ligjit.

Për këtë jemi përpjekur të krijojmë standardet më të mira, si dhe të pasqyrojmë përvojën e përvetësuar nga shkëmbimet me partnerët gjatë punës sonë. Nga ana tjetër jemi përpjekur në mënyrë të vazhdueshme të operojmë me integritet dhe gjithëpërfshirje me qëllim krijimin e një institucioni eficient, transparent dhe miqësor. Kjo filozofi jo gjithnjë mund të japë fryte të menjëhershme, por është një investim afatgjatë të cilin ne e shohim si mundësinë më të mirë për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, posaçërisht të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

ANEKS 1 - KONFERENCA E 41-të NDËRKOMBËTARE E KOMISIONERËVE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE DHE PRIVATËSISË (ICDPPC)

Zyra e Komisionerit organizoi Konferencën e 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (*International Conference of Data Protection and Privacy Commissioners – ICDPPC*), në datat 21 – 24 tetor 2019, në mjediset e Pallatit të Kongreseve. Konferenca Ndërkombëtare është forumi më i rëndësishëm i bashkëpunimit dhe koordinimit të Autoriteteve botërore të kësaj fushe dhe u zhvillua për herë të parë në Shqipëri e në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në procesin e përgatitjes së këtij aktiviteti, Zyra e Komisionerit u asistua nga Bordi Kombëtar dhe nga Komiteti Ndërkombëtar Këshillimor i Programit, në përbërje të të cilëve ishin ekspertë të njohur vendas dhe të huaj. Autoriteti bashkëpunoi për organizimin e Konferencës me një sërë institucionesh shqiptare dhe subjekte private.



Organi më i lartë drejtues i Konferencës Ndërkombëtare është Komiteti Ekzekutiv, anëtar i të cilit është edhe Zyra e Komisionerit. Konferenca ndahet në dy module, Sesioni i Mbyllur dhe Sesioni i Hapur. Sesioni i Mbyllur u zhvillua në datat 21 dhe 22 tetor 2019, me pjesëmarrjen e 220 delegatëve nga 90 Autoritete anëtare dhe vëzhguese të organizatës. Punimet e këtij Sesioni u përshëndetën nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi.





Gjatë punimeve të Sesionit të Mbyllur u miratuan 6 dokumente të rëndësishme:

- 1) Rezoluta për drejtimin strategjik të Konferencës;
- 2) Rezoluta për promovimin e instrumenteve të rinj dhe afatgjatë dhe për përpjekjet e vazhdueshme ligjore për bashkëpunim efektiv ndërkufitar;
- 3) Rezoluta ndërkombëtare për privatësinë si një e drejtë themelore e njeriut dhe parakusht për ushtrimin e të drejtave të tjera;
- 4) Rezoluta për mbështetjen dhe lehtësimin e bashkëpunimit rregullator mes Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Autoriteteve të Mbrojtjes së Konsumatorit e Konkurrencës për të arritur standarde të larta të mbrojtjes së të dhënave në ekonominë digjitale;
- 5) Rezoluta për të adresuar rolin e gabimit njerëzor në shkeljen e të dhënave personale;
- 6) Rezoluta për median sociale dhe materialet me përmbajtje të dhunshme/ekstremiste në internet.

Në kuadër të procesit të reformimit, Konferenca vendosi riemërtimin e organizatës në Asambleja Globale e Privatësisë (GPA).

Pjesë e agjendës së punimeve të Konferencës ishte dhe ndarja e Çmimeve Globale të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë. Ato përbëjnë vlerësimin e punës 1-vjeçare të Autoriteteve për ushtrimin e mandatit të tyre. Në kategorinë “*Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Publikut*” u shpall fitues Autoriteti i Kantonit të Zyrihut në Zvicër, për fushatën njohëse për fëmijët e moshave 4-9 vjeç. Në kategorinë “*Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe zbatimi i ligjit*” fitues u shpall Autoriteti i Zelandës së Re, për hetimin e zhvilluar në ministrinë e Zhvillimit Social të këtij vendi. Në kategorinë “*Inovacioni*”, fitues u shpall Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, për iniciativën e lançimit të një faqeje në internet për realizimin e hetimit administrativ online. Autoriteti i Spanjës u shpall fitues në dy kategori, atë të “*Përgjegjshmërisë*” dhe “*Çmimit të Publikut*” për projektin e një pyetëso online, i cili u shërben kryesisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Për herë të parë u akordua dhe një çmim i 6-të, nga organizatori i Konferencës, ku u nderua kontributi më shumë se 20-vjeçar i z. Giovanni Buttarellit, ish-Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, pas ndarjes së tij nga jeta në muajin gusht 2019.



Sesioni i Hapur, u zhvillua në datat 23 dhe 24 tetor, ku morën pjesë mbi 700 delegatë nga Autoritetet anëtare/vëzhguese të mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë, nga bota akademike, ekspertë dhe profesionistë të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale, nga shoqëria civile, biznesi, media, të ftuar nga vendi e bota, etj. Punimet e këtij sesioni u përshëndetën nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj.



Agjenda e Sesionit të Hapur ishte dinamike dhe gjithëpërfshirëse, me folës kryesorë:

- **Brad Smith**, President i Microsoft;
- **Jamie Bartlett**, gazetar dhe shkrimtar, prezantues i serisë ‘The Secrets of Silicon Valley – Sekretet e Luginës së Silikonit’ të BBC, themelues i organizatës ‘Demos’ dhe autor i bestsellerit ‘People vs Tech – Individët kundër Teknologjisë’;
- **Christopher Docksey**, Drejtues i Përgjithshëm Nderi i Mbikëqyrësit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (EDPS);



dhe e organizuar në 5 panele me 38 pjesëmarrës, me tematika:

- Konvergjenca globale në ligjin për mbrojtjen e të dhënave: ku po konvergojmë dhe çfarë progresi po bëjmë drejt standardeve të përbashkëta;
- Adresimi i sfidës globale të privatësisë për modelet e bizneseve që udhëhiqen nga të dhënat;
- Mbrojtja e të dhënave dhe konkurrenca si konvergues i rregullores digjitale: nga teoria në praktikë;
- Përgjegjshmëria - urë globale për të mbështetur standardet e larta të mbrojtjes së të dhënave;
- Sfidat e së ardhmes për Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave dhe nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave.



Gjatë Konferencës së 41-të Ndërkombëtare u zhvilluan edhe 25 aktivitete paralele (*side events*), nga Komisioni Evropian; Këshilli i Evropës; Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave; Rrjeti Global i Bashkëpunimit Ligj-zbatues të Privatësisë (GPEN); Departamenti Amerikan i Drejtësisë; Europol; Autoriteti Britanik i Mbrojtjes së të Dhënave; Forumi Botëror i Privatësisë; OECD; Rrejt i Ibero-Amerikan i Mbrojtjes së të Dhënave; Grupi Kërkimor mbi Legjislacionin, Shkencën, Teknologjinë dhe Shoqërinë; Rrjeti Afrikan i Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave; Agjencia Koreane e Internetit dhe Sigurisë; Dhoma e Tregtisë së SHBA; Këshilli i Industrisë së Teknologjisë së Informacionit të SHBA; Kolegji i Drejtësisë Uashington; Instituti Brookings në SHBA; Qendra për Politikën e Informacionit (CIPL); Fondacioni mbi Përgjegjshmërinë e Informacionit (IAF); OneTrust; Universiteti Vrije i Brukselit; GSMA; Facebook; Google; Universiteti Normal i Pekinit; Consulcesi Tech SA, etj



Zyra e Komisionerit, në kuadër të Konferencës Ndërkombëtare, organizoi pranë Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD) aktivitetin paralel (*side event*) me temë “*Mbrojtja e të Dhënave në Ekonominë Digjitale: Vendet e treta përballë GDPR*”. Kjo tryezë kishte si qëllim vendosjen e një dialogu për forcimin e ndërgjegjësimit dhe rritjen e gatishmërisë të të gjithë aktorëve të përfshirë në ekonominë digjitale, për t’u përballur me sfidat dhe risitë që sjell Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave. Panelistët, ekspertë vendas, përfaqësues nga Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacioni, por edhe ekspertë të huaj me ekspertizë të rëndësishme në këtë fushë dhe përfaqësues nga Autoriteti zviceran për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sollën këndvështrimet e tyre, praktikatat e deritanishme, problematikat e konstatuara dhe sugjeruan zgjidhjet e mundshme për arritjen e përputhshmërisë legislative kombëtare me GDPR.




